



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:076531

Datë: 18.04.2019

Numri i dokumentit: 00283456

PKR.nr.30/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për krime të rënda, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurit A. B. nga Gjilani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr. 34/2019 të datës 26.02.2018, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Arben Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datën 16 prill 2019, kur edhe është përpilua aktgjykimi, nxjerr dhe në prani të prokurorit të shtetit dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë, publikisht shpall këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri A. B. nga i ati dhe e ëma – e lindur, i lindur më në Gjilan, me vendbanim në fsh.Hodonovc, Komuna e Kamenicës, posedues i telefonit mobil me SIM karte 045-....., posedues i lejes së njoftimit me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, student në UBT në Prishtinë – shkencat e ushqimit dhe bioteknologjisë, i papunësuar, me gjendje të dobët ekonomike, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij, i pagjykuar, i është tërhiqur vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij nën kërcënim të pasojave ligjore,

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse prej datës 12 shkurt 2019, rreth orës 15:00 minuta, në fshatin Hodonvc, Komuna e Kamenicës, i pandehuri në kundërshtim me ligjin mbi armët ka mbajtur pistoletën me gas “Reck” mod. Goliath , me kalibër 9mm, P.A.K, me nr.serik K122445012, prodhimi gjerman dhe një karikator, të cila i konfiskohet nga ana e pjestarëve të Policisë së Kosovës,

- ashtu që me veprimet e tilla ka kryer veprën penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve** nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-s, dhe

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të cituara si dhe nenit 4, 7, 21 dhe 23, nenit 41, 46, 73 – 75 paragrafi 1.3 të KPRK-s si dhe nenit 365 lidhur me 248 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP-s), të pandehurin në fjalë

E G J Y K O N

Me DËNIM ME GJOBË në shumën prej **treqindë (300) Euro**, të cilën shumë detyrohet i pandehuri që ta paguaj në tri këste të barabarta edhe atë në shumën prej 100 Euro muaj, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të pranuar nga i pandehuri,

mirëpo, në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, atëherë dënimi i tillë,

I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, të cilin duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të ftesës nga gjykata, kur nuk e ka përmbush në tërësi apo pjesërisht dënimin me gjobë, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

II. Të pandehurit në fjalë në kuptim të nenit 374 paragrafi 3 të KPRK-s i shqiptohet

DËNIMI PLOTËSUES

duke ju konfiskuar pistoletën me gas “Reck” mod. Goliath, me kalibër 9mm, P.A.K, me nr.serik K122445012, prodhimi gjerman si dhe një karikator, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi duhet të shkatërrohen përmes komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate, duke u konstatuar nga Sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të kësaj gjykate me proceverbal përkatës, i cili duhet t’i bashkëngjitet kësaj lënde penale.

III. DETYROHET i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t’ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej **pesëdhjetë (50) Euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave shumën prej pesëdhjetë (50) Euro**, të gjitha në afat prej **tridhjetë (30) ditëve**, duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm,

A r s y e t i m

Organi i ndjekjes penale kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mirë, se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore për të cilën parashihet dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri pesë vjet. Në kuptim të nenit 45 të KPRK-s nëse minimumi i posaçëm nuk është i paraparë me dispozitën materiale atëherë zbatohet dënimi me burgim është 30 ditë si minimum i përgjithshëm kurse në kuptim të nenit 46 të KPRK-s paragrafi 1 të KPRK-s kur minimumi i posaçëm në normën materiale nuk është paraparë atëherë zbatohet minimumi i përgjithshëm prej 100 Euro gjobë.

Gjykata Themelore në Gjilan, për këtë lëndë penale sipas rendit të pranimit të lëndëve ka caktuar shqyrtimin fillestar duke i ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë, pasi që aktakuzës lëndore i është bashkëngjitur edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë e arritur mes palëve.

Palët gjatë seancës së shqyrtimit fillestar kanë mbetur në tërësi pranë marrëveshjes lëndore duke i theksuar rrethanat lehtësues që i kanë pas parasysh me rastin e arritjes së saj.

Gjykata pas vlerësimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë si dhe të deklaratave të palëve ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 233 paragrafi 18-22 lidhur me nenin 247 dhe 248 paragrafi 1 të KPP-s .

Andaj edhe ka vendos që rekomandimin për dënimin të arritur mes palëve sipas marrëveshjes lëndore ta aprovoj, me bindje se edhe me një dënim të tillë mund të arrihet qëllimi i plotë dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-s, në mënyrë që të rehabilitohet dhe parandalohet i pandehuri që në të ardhmen mos të kryej vepra penale, por edhe se do të ndikohet në disiplinimin e qytetarëve potencial, në mënyrë që të njëjtit mos të ndeshen me dispozitat ligjore me të cilat mbrohen të mirat vitale juridike të qytetarëve dhe shoqërisë si tërësi.

Gjykata pas shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit 368 të KPP-s palët i ka udhëzuar për të drejtën në ankesë, kurse palët shprehimisht kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë andaj edhe kryetari i trupit gjykues në kuptim të nenit 485 paragrafi 2 të KPP ka konstatuar se më datën **16 prill 2019** aktgjykim i shpallur është bërë i plotfuqishëm.

Po ashtu i pandehuri është njoftuar në mënyrë detale se me aktgjykim është i detyruar që ta paguaj dënimin me gjobë në këste të barabarta për tre muaj nga 100 Euro, mirëpo nëse nuk mundet ose nuk dëshiron ta paguaj të njëjtin atëherë në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s dënimi i tillë me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje përkatëse.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP ndërsa lidhur me taksën ligjore për kompenzimin e e viktimave të krimit në kuptim të nenit 39 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Ligji nr.05/L-036.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i krimeve të rënda
PKR.nr. 30/2019 më dt.16 prill të vitit 2019**

**Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Aziz Shaqiri**

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

VËREJTJE : në kuptim të nenit 485 paragrafi 2 të KPP-s pasi që shprehimisht palët kanë hequr dorë nga e drejta për ankesë, aktgjykim i lëndor është bërë i plotfuqishëm më datën 16 prill të vitit 2019.